

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Drejtimin Mësimor**

**PËRPPUNIM**  
**DRURI**

**Niveli I**

**Kodi: C-I-15**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2015**

## **Përmbajtja**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli I.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Përpunim druri” niveli I.
2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.

**III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor.**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli I.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin e drurit dhe prodhimin e objekteve prej druri”*. Zhvillimit të nxënësit i ndjenjës së vetëbesimit, kultivimi i vullnetit të lirë në marrjen e vendimeve, nxitja e gadishmërisë për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t’u zhvilluar individualisht në drejtimet emocionale, intelektuale dhe profesionale janë sfida të rëndësishme për arritjen e këtij qëllimi. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale i’u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës në fushën e përpunimit të drurit që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse si dhe vlerat e tyre morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri” niveli I, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- kanë aftësi të kufizuara, për të cilët shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë MMSR përgatit udhëzime të veçanta për pranimin në këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme kryesore të nxënësit në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.**

Në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I, nxënësi do të kenë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tyre dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt, procesin e të nxënësve të tyre dhe të shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojnë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësve në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I**

Në përfundimin me sukses të arsimit profesional në drejtimin **“Përpunim druri”, niveli I**, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të organizojë vendin e punës.
- Të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të lexojë dhe interpretojë skema të thjeshta të objekteve të ndryshme prej druri.
- Të ndihmojë në përgatitjen e vendit të punës për realizimin e punimeve të objekteve prej druri.
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura për punime të thjeshta zdrukhtare me vegla dore dhe mjete elektrike te dores.
- Të kryejë matje dhe shënime të thjeshta në elementet prej druri.
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës në punimet e thjeshta zdrukhtare.
- Të kryejë punime të thjeshta zdrukhtare me vegla dore: sharrë, zdrukthe, dalta, etj.
- Të kryejë punime të thjeshta zdrukhtare me vegla dore për axhustim dhe shpime.
- Të kryejë procese të thjeshta zdrukhtare me mjete të mekanizuara të dorës: sharrim, drejtim, zumparim, profilim dhe shpim.
- Të kryejë punime të thjeshta me makina bazë të përpunimit të drurit.
- Të realizojë punime të thjeshta veshje me teni, letër dhe PVC.
- Të përgatisë sipërfaqen për ngjitje.
- Të realizojë punime të thjeshta ngjitjeje.
- Të përgatisë sipërfaqen për lyerje.
- Të realizojë punime të thjeshta të lyerjes.
- Të vendosë aksesorë të thjeshtë metalikë në objekte me bazë druri.
- Të kryejë montime të thjeshta në objekte me bazë druri.
- Të stivojë materialin drunor për tharje.

- Të përzgjedhë llojin e lëndës së parë për prodhime gjysëm të gatshme prej druri.
- Të kryejë punime të thjeshta në prodhime gjysëm të gatshme prej druri.
- Të kryejë punime të thjeshta në prodhimimin e produkteve gjysëm të gatshmeve prej druri.
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit gjysëm të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim profesional, me të drejtë vazhdimin e arsimimit në nivelin II të arsimit profesional në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi.

Ky arsimim profesional i jep nxënësit mundësi t'i drejtohet tregut të punës si ndihmës në ndërmarrje të ndryshme të përpunimit të drurit ose ndërmarrje të tjera që kryejnë veprimtari në fushën e përpunimit të drurit. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e prodhimit të objekteve prej druri. Përsa i përket arsimimit të mëtejshëm, nxënësi ka mundësi të vazhdojë studimet në nivelin II të arsimit profesional, në një prej profileve të drejtimit mësimor “Përpunim druri”. Me vijimin e mëtejshëm të arsimit profesional në nivelin III, nxënësi fiton ”maturën profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I

Plani mësimor për drejtimin “Përpunim druri” Niveli I				
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Niveli I	
			Orët javore/vjetore	
			Klasa 10	Klasa 11
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)</b>	<b>15/17 (540/ 612)</b>	<b>11/13 (374/ 442)</b>
1		Gjuhë shqipe dhe letërsi	2	1
2		Gjuhë e huaj	2	2
3		Gjuhë e huaj 2 (me zgjedhje të lirë)	(2)	(2)
4		Qytetari	2	-
5		Histori	1	1
6		Matematikë	2	1
7		Fizikë	2	1
8		Kimi	1	2
9		Teknologji informimi e komunikimi	1	1
10		Edukim fizik	2	1
11		Edukim për karrierën	-	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale (Gjithsej)</b>	<b>10(360)</b>	<b>8 (272)</b>
1	L-01-012-08	Vizatim teknik	2	2
2	L-04-013-08	Detalet e makinave	2	-

3	L-09-014-15	Materiale për prodhimin e objekteve prej druri	3	2
4	L-09-015-15	Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit	2	2
5	L-09-016-15	Ndërtimi i objekteve prej druri	1	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>5</b> (180)	<b>10</b> (340)
1	M-09-029-08	Procese të punimit të drurit me vegla dore	36	-
2	M-09-030-11	Procese të punimit të drurit me pajisje të mekanizuara të dorës	36	-
3	M-09-031-08	Procese pune me makina bazë të përpunimit të drurit	36	-
4	M-09-032-11	Prodhimi i bishtave dhe dorezave prej druri për vegla	36	-
5	M-09-1118-15	Prodhimi i varëseve të rrobave dhe procese të lira	36	-
6	M-09-747-11	Prodhimi i koshit për mbeturina dhe i kutive të thjeshta	-	69
7	M-09-748-11	Prodhimi i stolit një e dy vendësh dhe i bangës së shkollës	-	69
8	M-09-039-11	Prodhimi i tabelës së klasës	-	66
9	M-09-040-11	Prodhimi i komodinës së thjeshtë	-	69
10	M-09-041-11	Prodhimi i karriges me elementë të drejtë	-	67
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar</b> (Gjithsej)	<b>1</b> (36)	<b>2</b> (68)
1	M-09-042-08	Prodhimi i ndenjësive të thjeshta me tapiceri	36	-
2	M-09-043-08	Prodhimi i krevatit për të rritur	36	-
3	M-09-044-08	Shtrimi i dyshemesë me dërrasë	-	68
4	M-09-045-08	Prodhimi i dyerve tamburato	-	68
5	M-09-1119-15	Ndërtimi i nyjes së kapriatës së thjeshtë me lëndë druri	-	68
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>31/33</b> (1116/ 1188)	<b>31/33</b> (1054/ 1122)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor është:

Në klasën 10, viti shkollor ka gjithësej 36 javë (36 javë mësimore)

Në klasën 11 viti shkollor ka gjithësej 36 javë (34 javë mësimore + 1 javë për provimin e praktikës profesionale + 1 javë për provimin e teorisë profesionale).

Një javë mësimore ka jo më shumë se 33 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta

Kurrikuli i arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MAS).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

## V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të drejtimit “**Përpunim druri**”, **niveli I**.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të drejtimit profesional “**Përpunim druri**”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me **nota** (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së njëmbëdhjetë, nxënësi i arsimuar në drejtimin profesional “**Përpunim druri**”, niveli I, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e përpunimit të drurit, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, për çdo vit shkollor, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit I.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në drejtimin “Përpunim druri”, niveli I**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli I shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MMSR, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale, për çdo vit shkollor;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit I.





## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Vizatim teknik” (L-01-012-08) Kl. 10 - 72 orë dhe Kl. 11 – 68 orë

#### Synimet e lëndës “Vizatim teknik”, kl. 10.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim teknik.”, klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë dhe qëllimin e vizatimit teknik.
- Të kryejnë vizatime të thjeshta me dorë të lirë.
- Të përzgjedhin dhe përdorin materialet, veglat dhe pajisjet për skicat dhe vizatimet teknike të thjeshta.
- Të zbatojnë standardet ndërkombëtare të vizatimit teknik.
- Të lexojnë dhe përdorin shkrimin teknik.
- Të shpjegojnë shkallët e paraqitjes së trupave në vizatim teknik.
- Të zbatojnë shkallët e vizatimit në vizatimet teknike.
- Të vizatojnë detale të ndryshme duke vendosur përmasat.
- Të lexojnë vizatime me përmasa të ndryshme.
- Të zbatojnë ndërtime gjeometrike kryesore.
- Të përshkruajnë llojet e projeksioneve.
- Të përshkruajnë rrafshet e projektimit.
- Të paraqesin projeksione ortogonale të thjeshta.
- Të paraqesin projeksione të figurave gjeometrike.
- Të vizatojnë projeksione ortogonale dhe aksonometrike të trupave gjeometrikë.
- Të vrojtojnë objektin.
- Të zgjedhin pozicionin e përshtatshëm të modelit.
- Të vizatojnë saktë modele të thjeshta me anë të pamjeve.
- Të ndërtojnë aksonometrinë e modeleve.

#### • Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Vizatim teknik”, kl 10 - 72 orë

<b>Tema 1</b>	Materialet dhe veglat e vizatimit teknik	2 orë
<b>Tema 2</b>	Vizatime të thjeshta me dorë të lirë	7 orë
<b>Tema 3</b>	Heqja e vijave në vizatimet teknike. Llojet e vijave	6 orë
<b>Tema 4</b>	Formatet standard, korniza dhe vula	2 orë
<b>Tema 5</b>	Shkrimi teknik	5 orë
<b>Tema 6</b>	Vendosja e përmasave dhe shkallët e vizatimit teknik	4 orë
<b>Tema 7</b>	Ndërtimet gjeometrike	5 orë
<b>Tema 8</b>	Metodat e projektimit, projektimi ortogonal	5 orë
<b>Tema 9</b>	Projeksionet e rrafshit dhe të figurave të rrafshëta	5 orë
<b>Tema 10</b>	Projeksionet aksonometrike	5 orë
<b>Tema 11</b>	Projeksionet ortogonale dhe aksonometrike të trupave gjeometrikë	6 orë
<b>Tema 12</b>	Projeksionet ortogonale të modeleve mësimore	6 orë
<b>Tema 13</b>	Skicat e modeleve	4 orë
<b>Tema 14</b>	Projeksionet aksonometrike të modeleve mësimore	5 orë
<b>Tema 15</b>	Prerjet dhe seksionet	5 orë

- **Synimet e lëndës “Vizatim teknik”, kl. 11.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Vizatim teknik”, klasa 11, nxënësit duhet:

- Të vizatojnë në projeksionet kryesore, prerje dhe seksione të thjeshta të detaleve mekanike.
- Të vizatojnë detale mekanike.
- Të vizatojnë lidhje mekanike të thjeshta si dhe të vendosin përmasat në to.
- Të lexojnë vizatime të objekteve me bazë druri.
- Të vizatojnë objekte të thjeshta me bazë druri.
- Të vizatojnë detalet, sipas radhës, me numrin e nevojshëm të pamjeve gjatë zbrërthimit të një objekti të thjeshtë prej druri.
- Të paraqesin në vizatim mbishtesat për punim.
- Të vizatojnë dyer dhe dritare të thjeshta.
- Të dallojnë dhe lexojnë llojet e vizatimeve të ndryshme skematike.
- Të vizatojnë objekte të thjeshta tapicerie.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës“Vizatim teknik”, kl 11- 68 orë:**

<b>Tema 1</b>	Prerjet dhe seksionet	8 orë
<b>Tema 2</b>	Vizatimi i detaleve dhe lidhjeve mekanike	10 orë
<b>Tema 3</b>	Vizatimi i pjesëve përbërse të objekteve prej druri	10 orë
<b>Tema 4</b>	Vizatimi përmbledhës i objekteve prej druri	14 orë
<b>Tema 5</b>	Vizatimi i dyerve dhe i dritareve	10 orë
<b>Tema 6</b>	Vizatimet skematike	8 orë
<b>Tema 7</b>	Vizatimi i objekteve të tapicuara	8 orë

## **2. Lënda “Detalet e makinave” (L-04-013-08) Kl. 10 - 72 orë**

- **Synimet e lëndës “Detalet e makinave”, kl. 10 – 72 orë.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Detalet e makinave” klasa 10, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë materialet metalike.
- Të klasifikojnë materialet metalike.
- Të tregojnë përdorimet e materialeve metalike.
- Të përshkruajnë materialet jo metalike.
- Të klasifikojnë materialet jo metalike.
- Të dallojnë detalet e nyjet e makinave, si dhe rëndësinë e tyre në funksionimin e makinës.
- Të rendisin llojet e lidhjeve mekanike, me vidë, dado-bullon, kiavetë, perçinë, saldim.
- Të dallojnë llojet e transmesioneve, me rip, me ingranazhe, me yllëza, me fërkim dhe përdorimet e tyre
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit mekanik, hidraulik, pneumatik në presa.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Detalet e makinave”, kl. 10 - 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Materialet metalike	15 orë
<b>Tema 2</b>	Materialet jo metalike	8 orë
<b>Tema 3</b>	Detalet dhe nyjet e makinave	11 orë
<b>Tema 4</b>	Lidhjet mekanike	13 orë
<b>Tema 5</b>	Transmisionet	15 orë
<b>Tema 6</b>	Sistemet mekanike, hidraulike dhe pneumatike	10 orë

### **3. Lënda “Materiale për prodhimin e objekteve prej druri” (L-09-014-15). Kl. 10 - 108 orë, Kl. 11 - 68 orë**

- **Synimet e lëndës ”Materiale për prodhimin e objekteve prej druri”, kl. 10 - 108 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Materiale për prodhimin e objekteve prej druri” nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë rëndësinë e drurëve pyjorë.
- Të përcaktojnë pjesët dhe përshkruajnë funksionin e tyre.
- Të dallojnë elementet e strukturës makroskopike të drurit.
- Të shpjegojnë funksionin e elementeve të strukturës makroskopike.
- Të analizojnë vetitë e blanës dhe nyjës.
- Të analizojnë strukturën mikroskopike të drurit.
- Të shpjegojnë funksionin e secilit element të strukturës mikroskopike.
- Të listojnë llojet e drurëve kryesorë të vëndit tonë sipas karakteristikave dhe përdorimeve të tyre.
- Të përshkruajnë rëndësinë, vetitë fizike dhe përdorimet e drurit.
- Të përshkruajnë vetitë mekanike, faktorët dhe ndikimin e tyre në përdorimin e drurit.
- Të përshkruajnë përbërjen kimike të drurit dhe rëndësinë e secilit përbërës në dru dhe në degë të tjera të industrisë.
- Të përshkruajnë defektet e drurit.
- Të klasifikojnë defektet e drurit.
- Të shpjegojnë ndikimin e defekteve në përdorimin e drurit dhe masat për mënjanimin e tyre gjatë prerjes.
- Të përshkruajnë lagështirën dhe ndikimin e saj në vetitë e drurit.
- Të rendisin mënyrat e përmirësimit të vetive të drurit.
- Të përshkruajnë mënyrat e ruajtjes së drurit.
- Të përshkruajnë mënyrat e imprenjimit të drurit me antiseptikë apo lëndë ngjyruese
- Të përshkruajnë mënyrat e tharjes natyrale dhe artificiale të drurit.
- Të rendisin prodhimet gjysëm të gatshme prej druri.
- Të përshkruajnë rëndësinë e prodhimeve gjysëm të gatshme.
- Të rendisin karakteristikat e lëndës të parë, për prodhimin e lëndës së sharruar.
- Të përshkruajnë hapat e teknologjisë për prodhimin e lëndës së sharruar.
- Të shpjegojnë mënyrën e organizimit të depozitës të trupave në fabrikën e lëndës së sharruar.
- Të rendisin kriteret e ndarjes së dërrasave në asortimente.
- Të dallojnë cilësitë e asortimenteve të dërrasave.
- Të dallojnë karakteristikat e lëndës të parë për rimeso dekorative, kompesatë dhe dru i shtresuar.

- Të përshkruajnë hapat e teknologjisë për prodhimin e rimesos dekorative, kompensatës dhe drurit të shtresuar.
- Të përshkruajnë cilësitë dhe përdorimet e rimesos dekorative, kompensatës dhe drurit me shtresa.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të vetive fiziko-mekanike.
- Të rendisin asortimentet e lëndës të parë, lëndët ndihmëse për pllakë zdrukthi dhe fibre.
- Të dallojnë veçoritë e asortimenteve të lëndës të parë dhe ndihmëse për pllakë zdrukthi dhe fibre.
- Të klasifikojnë pllakën e zdrukthit dhe të fibrës sipas vetive fiziko- mekanike.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të këtyre vetive.
- Të përshkruajnë hapat e teknologjisë të pllakës së zdrukthit dhe fibrës.
- Të përshkruajnë vetitë fiziko- mekanike të pllakave qelizore dhe panel si dhe hapat e teknologjisë të prodhimit të tyre.
- Të rendisin masat e sigurisë dhe mbrojtjes të mjedisit në fabrika.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Materiale për prodhimin e objekteve prej druri” kl. 10- 108 orë:**

<b>Tema 1</b>	Druri	4orë
<b>Tema 2</b>	Ndërtimi makroskopik i drurit	10 orë
<b>Tema 3</b>	Ndërtimi anatomik i drurit	9 orë
<b>Tema 4</b>	Drurët kryesorë të vendit tonë	8 orë
<b>Tema 5</b>	Vetitë fizike të drurit	10 orë
<b>Tema 6</b>	Përbërja kimike e drurit	7 orë
<b>Tema 7</b>	Vetitë mekanike të drurit	10 orë
<b>Tema 8</b>	Defektet e drurit	12 orë
<b>Tema 9</b>	Ruajtja dhe trajtimi i drurit	8 orë
<b>Tema 10</b>	Lënda e sharruar	4 orë
<b>Tema 11</b>	Tharja e drurit	8 orë
<b>Tema 12</b>	Prodhime gjysëm të gatshme prej druri	2 orë
<b>Tema 13</b>	Rimeso, kompensatë dhe druri me shtresa	6 orë
<b>Tema 14</b>	Pllaka e zdrukthit dhe e fibrës	6 orë
<b>Tema 15</b>	Pllaka qelizore dhe panel	4 orë

• **Synimet e lëndës ”Materiale për prodhimin e objekteve prej druri” kl. 11 - 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Materiale për objekte prej druri” nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë materialet për ngjitje.
- Të dallojnë materialet për ngjitje.
- Të shpjegojnë përgatitjen dhe përdorimet e materialeve për ngjitje.
- Të klasifikojnë materialet për lyerje dhe ilustrime me dorë.
- Të shpjegojnë përgatitjen dhe përdorimet e materialeve për lyerje dhe ilustrim me dorë .
- Të rendisin materialet metalikë.
- Të dallojnë përdorimet e materialeve metalike.
- Të rendisin materialet e tapicerisë.
- Të përshkruajnë cilësitë e përdorimit të materialeve të tapicerisë.
- Të rendisin materiale të tjera për prodhimin e objekteve prej druri.
- Të dallojnë vetitë e materialeve të tjera për prodhimin e objekteve prej druri.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Materiale për prodhimin e objekteve prej druri" kl. 11- 68 orë:**

<b>Tema 1</b>	Materialet për ngjitje	12 orë
<b>Tema 2</b>	Materialet e lyerjes dhe të ilustrimit të mobilies	22 orë
<b>Tema 3</b>	Materialet metalikë	14 orë
<b>Tema 4</b>	Materialet e tapicerisë	12 orë
<b>Tema 5</b>	Materiale të tjera	8 orë

#### **4. Lënda "Veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit" (L-09-015-15). Kl. 10 - 72 orë Kl. 11 –68 orë**

- **Synimet e lëndës "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit", kl. 10 - 72 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Vegla dhe makinat të përpunimit të drurit", klasa 10, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë bazat e përpunimit mekanik të drurit.
- Të theksojnë vecoritë e përpunimit mekanik të drurit.
- Të përshkruajnë faktorët që ndikojnë në përpunimin mekanik të drurit.
- Të përshkruajnë veglat e thjeshta për përpunimin e drurit me dorë.
- Të shpjegojnë pjesët përbërse dhe përdorimet e veglave të thjeshta, për përpunimin e drurit me dorë.
- Të shpjegojnë proceset e punës, me mjetet e mekanizuara, të përpunimit të drurit.
- Të klasifikojnë mjetet e mekanizuara për përpunimin e drurit të drejtuar me dorë.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe përdorimet e mjeteve të mekanizuara.
- Të lexojnë skemat e punës dhe të funksionimit të makinave të sharrimit me avanc dhe me dorë.
- Të dallojnë llojet dhe përdorimet e makinave të sharrimit me avanc dhe me dorë.
- Të lexojnë skemën e punës së makinës plan drejtues.
- Të lexojnë skemën e punës së makinës së kombinuar për sharrim dhe drejtim.
- Të rendisin llojet e instrumentave prerës në veglat dhe makineritë e përpunimit të drurit.
- Të shpjegojnë karakteristikat dhe përdorimin e lamës shirit, disk dhe thikave të zdruckthimit.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit", kl. 10 – 72 orë**

<b>Tema 1</b>	Bazat e përpunimit mekanik të drurit	5 orë
<b>Tema 2</b>	Veglat e thjeshta të dorës për përpunimin e drurit	14 orë
<b>Tema 3</b>	Mjetet e mekanizuara të dorës për përpunimin e drurit	14 orë
<b>Tema 4</b>	Makinat e sharrimit të drurit	15 orë
<b>Tema 5</b>	Instrumenta prerës të sharrimit	4 orë
<b>Tema 6</b>	Makinat plan-drejtuese	12orë
<b>Tema 7</b>	Instrumenta prerës të zdruckthimit.	4orë
<b>Tema 8</b>	Makina e kombinuar për sharrim dhe drejtim	4 orë

- **Synimet e lëndës "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit", kl. 11- 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit" nxënësit duhet:

- Të lexojnë skemat e punës të makinave të nxjerrjes së detaleve në trashësinë e duhur (një, dy , tre dhe katër anësore).
- Të përshkruajnë funksionimin e makinave të nxjerrjes së detaleve në trashë sinë e duhur dhe mekanizmin e lëvizjes së tyre në të.
- Të lexojnë skemën e punës të frezës me bosht nga poshtë.
- Të shpjegojnë ndërtimin e boshtit dhe të thikave të frezës.
- Të rendisin punimet e thjeshta që kryhen në makinën frezë me bosht poshtë.
- Të klasifikojnë makinat e shpimit.
- Të dallojnë veçoritë e skemave të punës në makinat e shpimit.
- Të dallojnë llojet e instrumentave të shpimit.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe përdorimet e tyre.
- Të përshkruajnë përgatitjen për punë, mënyrën e punimit si dhe llojet e punimeve që kryhen në makinat e shpimit të drurit.
- Të dallojnë llojet dhe veçoritë e përdorimit të makinave të zumparimit.
- Të përshkruajnë procesin e ngjitjes së shiritit.
- Të listojnë operacionet e mirëmbajtjes të instrumentave prerës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e operacioneve të mirëmbajtjes të instrumentave prerës.
- Të përshkruajnë procesin e ngjitjes së shiritit.
- Të shpjegojnë mënyrën e mprehjes së lamave.
- Të dallojnë metodën e mprehjes me dorë nga ajo me makinë.
- Të shpjegojnë mënyrën e mprehjes së thikave të zdrukthimit dhe rëndësinë e ruajtjes të parametrave këndorë.

- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Veglat dhe makinat e përpunimit të drurit" kl. 11 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Makina grosecë	13 orë
<b>Tema 2</b>	Makina frezë me bosht vertikal nga poshtë	10 orë
<b>Tema 3</b>	Makina frezë kopjuese	6 orë
<b>Tema 4</b>	Makinat e shpimit	8 orë
<b>Tema 5</b>	Instrumentat e shpimit të drurit	6 orë
<b>Tema 6</b>	Makinat e zumparimit	9 orë
<b>Tema 7</b>	Operacione mirëmbajtje të thjeshta të instrumentave prerës	5 orë
<b>Tema 8</b>	Ngjitja e lamës shirit	4 orë
<b>Tema 9</b>	Mprehja e lamave me dorë dhe makinë	6 orë
<b>Tema 10</b>	Mprehja e thikave të planit	4 orë

### 5. Lënda "Ndërtimi i objekteve prej druri" (L-09-016-15). Kl. 10 – 36 orë Kl. 11 - 68 orë

- **Synimet e lëndës "Ndërtimi i objekteve prej druri", kl. 10 - 36 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Ndërtimi i objekteve prej druri" nxënësit duhet:

- Të klasifikojnë veglat dhe pajisjet ndihmëse në ndërtimin e objekteve prej druri.

- Të shpjegojnë paisjet për shtrëngim, ngjitje të detaleve prej druri.
- Të shpjegojnë paisjet për tapicimin e drurit.
- Të dallojnë pajisjet për bordimin e drurit.
- Të dallojnë përdorimet e pajisjeve ndihmëse.
- Të rendisin pjesët përbërëse të objekteve prej druri duke lexuar skicën.
- Të shpjegojnë rëndësinë e seicilës pjesë në qëndresën e objektit.
- Të shpjegojnë veçoritë e ndërtimit dhe vendin që zënë në objekt.
- Të përshkruajnë proceset e ngjitjes dhe formimit të pjesëve të objektit të thjeshtë
- Të shpjegojnë mënyrat e montimit dhe në vecanti montimin e objekteve të thjeshta.
- Të shpjegojnë hapat e përgatitjes të sipërfaqes për lyerje.
- Të shpjegojnë mënyrën e lyerjes, me boj e llak, të sipërfaqeve prej druri.
- Të shpjegojnë mënyrën e tharjes të sipërfaqeve, prej druri, të lyera me boj dhe llak.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Ndërtimi i objekteve prej druri" kl. 10 - 36 orë**

<b>Tema 1</b>	Veglat dhe pajisjet ndihmëse në ndërtimin e objekteve prej druri	8 orë
<b>Tema 2</b>	Pjesët përbërëse të objekteve prej druri	8 orë
<b>Tema 3</b>	Proceset e ngjitjes dhe formimit të pjesëve të objektit prej druri	8 orë
<b>Tema 4</b>	Montimi horizontal i objekteve prej druri	6 orë
<b>Tema 5</b>	Lyerja dhe ilustrimi i pjesëve të objektit prej druri	6 orë

• **Synimet e lëndës "Ndërtimi i objekteve prej druri", kl. 11 - 68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës "Ndërtimi i objekteve prej druri" nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë radhën e punës për montimin e elementeve metalike në objektet prej druri.
- Të shpjegojnë mënyrën e përgatitjes së detaleve dhe pjesëve të përkulura me mjete të thjeshta.
- Të klasifikojnë objektet prej druri sipas ndërtimit, përmasave dhe përdorimit.
- Të shpjegojnë kriteret e klasifikimit të objekteve prej druri.
- Të dallojnë veçoritë e ndërtimit të objekteve të thjeshta të tapicerisë.
- Të dallojnë elementet e kapriatës së thjeshtë prej druri me lëndë të rrumbullakët dhe të sharruar.
- Të rendisin hapat teknologjikë për ndërtimin e kapriatës së thjeshtë prej druri.
- Të rendisin hapat për montimin e elementeve të kapriatës së thjeshtë prej druri.
- Të përshkruajnë elementet konstruktive prej druri të ndërtesave të thjeshta prej druri (ndërkate, shkallë, shtylla, trarë dhe mure).
- Të rendisin hapat teknologjikë për ndërtimin e ndërtesave të thjeshta prej druri (ndërkate, shkallë, shtylla, trarë dhe mure).
- Të rendisin hapat teknologjikë për montimin e elementeve konstruktive prej druri në ndërtesat e thjeshta prej druri (ndërkate, shkallë, shtylla, trarë dhe mure).
- Të shpjegojnë mënyrën e llogaritjes së lëndës së parë dhe materialeve të tjera për objekte të thjeshta prej druri, si dhe për elementet konstruktive të kapriatave dhe ndërtesave të thjeshta prej druri.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Ndërtimi i objekteve prej druri” kl. 11- 68 orë:

<b>Tema 1</b>	Vendosja e elementeve metalikë në objekte prej druri	10 orë
<b>Tema 2</b>	Përgatitja e detaleve e pjesëve të përkulura me mënyra të thjeshta	8 orë
<b>Tema 3</b>	Objektet prej druri të mjediseve të banimit	10 orë
<b>Tema 4</b>	Objektet prej druri për institucione	8 orë
<b>Tema 5</b>	Objektet të tjera prej druri	7 orë
<b>Tema 6</b>	Objekte druri të tapicuara	10 orë
<b>Tema 7</b>	Konstruksione ndërtimi prej druri	8 orë
<b>Tema 8</b>	Mënyra e llogaritjes së lëndës së parë dhe materialeve të tjera për objekte të thjeshta prej druri dhe konstruksioneve të ndërtimit prej druri	7 orë





## IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

### 1. Moduli: “Procese të punimit të drurit me vegla dore”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 10

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROCESE TE PUNIMIT TE DRURIT ME VEGLA DORE	(M-09-029-08)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune në materialin drunor, me vegla të thjeshta dore.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për procese të punimit të drurit me vegla dore.**

***Përmbajtja***

- Analiza e vizatimeve dhe skicave.
- Përcaktimi i radhës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve.
- Përzgjedhja e veglave të dorës.
- Përzgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.
- Transportimi i materialeve, veglave dhe mjeteve në vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta në materialin drunor;
- të përshkruajë saktë radhën e punimeve;
- të zgjedhë materialin e punës sipas prodhimit, përdorimit dhënies së formës dhe lagështisë së drurit;
- të zgjedhë, sipas procesit të punës, veglat prerëse;
- të zgjedhë, sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;
- të vendosë, me kujdes, materialin, veglat, pajisjet dhe instrumentet prerës në vendin përkatës të punës;

## **RM 2 Nxënësi kryen procese të punimit të drurit me sharrë dore**

### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Mprehja e sharrës
- Çaprazimi i sharrës.
- Sharrimi i materialit me sharrë dore.
- Kontrolli i sharrimit.
- Mirëmbajtja e sharrave dhe pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së sharrimit me sharrë dore.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë saktë dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të mprehë sharrën sipas parametrave këndorë;
- të bëjë çaprazimin sipas lartësisë së dhëmbit me çelës të thjeshtë çaprazi;
- të sharrojë materialin, sipas shënimit, me sharra të ndryshme dore;
- të kontrollojë sharrimet, sipas shënimit;
- të mirëmbajë sharrat, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me sharra dore.

## **RM 3 Nxënësi kryen punime të drurit me zdrukthe dore.**

### ***Përmbajtja:***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Mprehja e thikave të zdrukthit.
- Zdukthtimi i materialit.
- Kontrolli i zdrukthimit.
- Mirëmbajtja e zdrukthit, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me zdrukthe dore.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë saktë dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të mprehë thikën e zdrukthit sipas parametrave këndorë;
- të zdukthtojë materialin me zdrukthe të ndryshme dore, sipas shënimit;
- të kontrollojë materialet e zdrukthtuara, sipas skicës;
- të mirëmbajë zdrukthet dhe pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me zdrukthe dore.

#### **RM 4 Nxënësi kryen procese pune axhustimi me vegla dore**

##### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Përgatitja e veglës prerëse për punë.
- Punimi me daltë.
- Rrashinimi materialit.
- Punimi me limë.
- Zumparimi i materialit.
- Kontrolli i punimeve të bëra.
- Mirëmbajtja e veglave prerëse, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me dalta, rrashina, shina lima dhe letër zumpare.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shënojë materialin sipas skicës;
- të përgatitë veglën prerëse për punë, sipas parametrave;
- të punojë me daltë materialin sipas shënimit;
- të rrashinojë materialin drunor sipas skicës;
- të punojë me limë sipas modelit;
- të zumparojë materialin drunor sipas shkallës të pastërtisë;
- të kontrollojë me kujdes punimet e bëra;
- të mirëmbajë me kujdes veglat prerëse, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me dalta, rrashina, lima dhe letër zumpare;

#### **RM 4 Nxënësi kryen procese pune me vegla dore shpimi**

##### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Përgatitja e veglës prerëse për punë.
- Shpimi i detaleve.
- Pastrimi nga mbeturinat.
- Kontrolli i foleve të kryera.
- Mirëmbajtja e veglave prerëse, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me mjete shpimi.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e realizimit***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë saktë dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të përgatitë veglën prerëse për punë, sipas diametrit të

- shpimit;
- të shpojë detalet sipas shënimit;
- të pastrojë me kujdes mbeturinat e ashklave;
- të kontrollojë sipas përmasave në skicë foletë e kryera;
- të mirëmbajë me kujdes veglat e shpimit me dorë, pajisjet matëse dhe kontrolluese;
- të zbatojë me kujdes rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me veglat e shpimit me dorë;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të matjes, shënimit, sharrimit, zdrukthimit, etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje, shënime, sharrime, zdrukthime etj., fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës me vegla dore të thjeshta të përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës me vegla dore të përpunimit të drurit dhe materialeve me bazë druri.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me vegla dore.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me vegla dore.
  - Lëndë e parë drunore.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- 



## 2. Moduli “Procese të punimit të drurit me pajisje të mekanizuara të dorës”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 10

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PROCESE TE PUNIMIT TE DRURIT ME PAJISJE TË MEKANIZUARA TË DORËS	(M-09-030-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit, për të kryer procese pune në materialin drunor, me pajisje të mekanizuara të dorës.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për punime të drurit me pajisje të mekanizuara të dorës.**

***Përmbajtja***

- Analiza e vizatimeve dhe skicave.
- Përcaktimi i radhës së punës.
- Përzgjedhja e materialeve.
- Përzgjedhja e pajisjeve të mekanizuara të dorës.
- Përzgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.
- Transportimi i materialeve, pajisjeve prerese, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e duhur.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta në materialin drunor;
- të përshkruajë saktë radhën e punimeve;
- të zgjedhë materialin e punës sipas prodhimit, përdorimit dhënies së formës dhe lagështisë së drurit;
- të zgjedhë pajisjet e mekanizuara të dorës sipas procesit të punës,;
- të zgjedhë mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese sipas kërkesës;
- të vendosë materialin, pajisjet e mekanizuara të dorës dhe instrumentet prerës në vendin përkatës;

**RM 2 Nxënësi kryen procese pune me sharra të mekanizuara të dorës**

***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Mprehja e sharrës.
- Çaprazimi i sharrës.
- Sharrimi i materialit.
- Kontrolli i sharrimit.
- Mirëmbajtja e sharrave, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me sharra të mekanizuara të dorës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe shënojë materialin sipas skicës.
- të mprehë sharrën sipas parametrave këndorë;
- të bëjë çaprazimin sipas lartësisë të dhëmbit me çelës të thjeshtë çaprazi;
- të sharrojë materialin me sharra të ndryshme të mekanizuara të dorës, sipas shënimit;
- të kontrollojë sharrimet sipas shënimit;
- të mirëmbajë sharrat e mekanizuara të dorës, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me sharra të mekanizuara të dorës.

**RM 3 Nxënësi kryen procese pune me zdrukthe të mekanizuara të dorës**

***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Mprehja e thikave të zdrukthit.
- Zdrukthtimi i materialit.
- Drejtimi i materialit.
- Kontrolli i drejtimit.
- Mirëmbajtja e zdrukthit, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me zdrukthe të mekanizuara të dorës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të mate dhe shënojë materialin, sipas skicës;
- të mprehë thikën e zdrukthit sipas parametrave këndorë;.
- të zdrukthtojë materialin me zdrukth të mekanizuara të dorës, sipas shënimit;
- të drejtojë materialin në faqe dhe në brinjë sipas shënimit me zdrukthe të ndryshme të mekanizuara të dorës;

- të kontrollojë sipas skicës materialet e zdrukthtuara;
- të mirëmbajë zdrukthet e mekanizuara të dorës, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me zdrukthe të mekanizuara të dorës.

#### **RM 4 Nxënësi kryen procese pune të shpim-pastrimit me pajisje të mekanizuara të dorës**

##### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e mjeteve të mekanizuara të dorës.
- Matja dhe shënimi i materialit.
- Zumparimi i materialit.
- Kontrolli i zumparimit.
- Shpimi i materialit.
- Pastrimi i materialit nga mbeturinat.
- Kontrolli i foleve të kryera..
- Mirëmbajtja e veglave prerëse, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës, me pajisje të mekanizuara të dorës për shpim-pastrimin e materialit drunor.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë sipas parametrave pajisjet e mekanizuara të dorës për shpim-pastrimin e materialit drunor.
- të mate dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të zumparojë me pajisje të mekanizuar dore me shirit, të sheshtë, të rumbullakët sipas shkallës të pastërtisë;
- të kontrollojë me kujdes zumparimet e bëra;
- të shpojë materialin sipas shënimit;
- të pastrojë me kujdes mbeturinat e ashklave.
- të kontrollojë foletë e realizuara sipas përmasave në skicë;
- të mirëmbajë me kujdes veglat prerëse, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me mjete të mekanizuara dore për shpim-pastrimin e drurit dhe materialeve me bazë druri.

#### **RM 5 Nxënësi kryen ngjitjen e materialit të drurit me mjete të mekanizuara të dorës**

##### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Përgatitja e veglës prerëse për punë.
- Hapja e kanaleve me frezë.

- Profilimi i detalit.
- Shkallëzimi me frezë.
- Mbërthimi dhe vidimi.
- Ngjitja e tenisë.
- Qethja e tenisë.
- Mbërthimi me grafitë i elementeve.
- Mirëmbajtja e pajisjeve të mekanizuara të dorës dhe e mjeteve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë materialin sipas skicës.
- të përgatisë pajisjet e mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, për punë;
- të hapë kanale me frezë të mekanizuar dore, sipas shënimit.
- të realizojë profilim të detalit me frezë të mekanizuar dore sipas skicës.
- të shkallëzojë materialin me frezë të mekanizuar dore sipas modelit.
- të realizojë mbërthime dhe vidime në materialin drunor.
- të ngjitë teni, rimeso, plastikë sipas kërkesës, në brinjë me pajisje të mekanizuar të dorës.
- të pastrojë me kujdes tepricat e tenisë.
- të mbërthejë me grafitë elementet prej druri.
- të mirëmbajë pajisjet e mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, mjetet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantë profesionalë të përpunimit drunor (zdukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete së proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, të drurit dhe materialeve me bazë druri.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e



---

proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, të drurit dhe materialeve me bazë druri.

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së perpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, të drurit dhe materialeve me bazë druri.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me pajisje të mekanizuara të dorës për profilim dhe ngjitje, të drurit dhe materialeve me bazë druri.
  - Lëndë e parë drunore.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

### 3 Moduli: “Procese pune me makina bazë të përpunimit të drurit”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 10

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodit **PROCESE PUNE ME MAKINA BAZË TË PËRPUNIMIT TË DRURIT** (M-09-031-08)

**Qëllimi i modulit** Një modul që i aftëson nxënësit për të kryer procese pune, në materialin drunor, me pajisje të mekanizuara të dorës.

**Kohëzgjatja e modulit** 36 orë mësimore

**Niveli i parapëlqyer për pranim** Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për procese pune me makinat bazë të përpunimit të drurit.**

***Përmbajtja***

- Analiza e vizatimeve dhe skicave.
- Përcaktimi i radhës së punës.
- Zgjedhja e materialeve.
- Zgjedhja e makinave të përpunimit të drurit.
- Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.
- Transportimi i materialeve, pajisjeve prerese, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve të thjeshta në materialin drunor;
- të përshkruajë saktë radhën e punimeve;
- të zgjedhë materialin e punës ipas prodhimit, përdorimit dhënies së formës dhe lagështisë së drurit;
- të zgjedhë makinën e përpunimit të drurit, sipas procesit të punës;
- të zgjedhë mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese sipas kërkesës;
- të vendosë materialin pranë makinës me kujdes;

**RM 2 Nxënësi kryen procese pune me makinat sharrë**

***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i materialit.
- Mprehja e instrumentit prerës

- Çaprazimi i sharrës.
- Sharrimi i materialit.
- Shkurtimi i materialit.
- Kontrolli i sharrimit.
- Mirëmbajtja e makinave të sharrimit, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me sharra të mekanizuara të dorës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të mate dhe shënojë materialin sipas skicës;
- të mprehë sharrën sipas parametrave këndorë;
- të bëjë çaprazimin me çelës të thjeshtë çaprazi sipas lartësisë të dhëmbit;
- të sharrojë materialin me makinë sharrë shirit sipas shënimit;
- të shkurtojë materialin me makinë sharrë disk sipas shënimit;
- të kontrollojë sharrimet sipas shënimit;
- të kontrollojë materialet e sharruara me makina sipas skicës;
- të mirëmbajë makinat sharre shirit dhe disk, pajisjet matëse dhe kontrollues;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punimeve me makinat e sharrimit.

**RM 3 Nxënësi kryen procese pune me makinat plan grosecë.**

***Përmbajtja***

- Përgatitja e makinave për punë
- Drejtimi i materialit në faqe.
- Drejtimi i materialit në brinjë.
- Kontrolli i drejtimit.
- Punimi në makinën grosecë.
- Kontrolli i nxjerrjes në trashësi.
- Mirëmbajtja e thikave, makinave plan , grosecë, pajisjeve matëse dhe kontrolluese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës, me makinën plan dhe grosecë për drejtim dhe nxjerrjen në trashësi të materialit drunor.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë makinat për punë sipas trashesisë të materialit
- të drejtojë materialin në sipërfaqe sipas kërkesës në makinën plan drejtuese;

- të drejtojë materialin në brinjë sipas kerkesës në makinën plan drejtuese;
- të kontrollojë me kujdes saktësinë e drejtimit;
- të realizojë sipas skicë trashësinë e materialit në makinën grosecë;
- të kontrollojë me kujdes nxjerrjen e trashësisë;
- të mirëmbajë me kujdes thikat, makinat plan, grosecë, pajisjet matëse dhe kontrolluese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë kryerjes së proceseve të punës, me makinën plan dhe grosecë për drejtim dhe nxjerrje në trashësi të materialit drunor.

#### **RM 4 Nxënësi kryen procese pune me makinat e zumparimit.**

##### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e makinës për punë.
- Zumparimi i elementeve në sipërfaqe.
- Zumparimi i elementeve në brinjë.
- Zumparimi i elementeve në qoshe.
- Zumparimi në punime të rrumbullakta.
- Mirëmbajtja e makinave të zumparimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës me makina zumparimi.

##### ***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë makinën për punë sipas parametrave të kërkuara;
- të bëjë zumparime të elementeve në sipërfaqe;
- të bëjë zumparimin e elementeve në brinjë;
- të bëjë zumparimin e elementeve në qoshe;
- të bëjë zumparime në punime të rrumbullakta;
- të mirëmbajë siç duhet makinat e zumparimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës me makina zumparimi.

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant. profesionale të përpunim drurit (zdukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të së proceseve të punës me makinat sharrë, grosecë dhe të zumparimit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete të proceseve të punës me makinat sharrë, grosecë dhe të zumparimit.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës me makina bazë të përpunimit të drurit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës me makina bazë të përpunimit të drurit.

- 
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me makina bazë të përpunimit të drurit.
  - Komploti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me makina bazë të përpunimit të drurit.
  - Lëndë e parë.
  - Katalloge, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- 



#### 4. Moduli: “Prodhimi i bishtave dhe dorezave prej druri për vegla”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 10

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kod	PRODHIMI I BISHTAVE E DOREZAVE PREJ DRURI PER VEGLA	(M-09-032-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të prodhuar bishta e doreza për vegla dore me mjete të thjeshta.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

#### **RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e bishtave dhe dorezave prej druri për vegla**

##### ***Përmbajtja***

- Analiza e vizatimit teknik ose e skicës së bishtave dhe dorezave të veglave.
- Përgatitja e “tabelës së prerjes”.
- Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e bishtave dhe dorezave për vegla.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjet dhe makinave për prodhimin e bishtave dhe dorezave të veglave.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të paraqesë në vizatim ose të skicojë bishtat dhe dorezat e veglave;
- të përgatisë “ tabelën e prerjes”, sipas hapave të punës.
- të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e bishtave dhe dorezave për vegla;
- të përzgjedhë saktë mjete, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e bishtave dhe dorezave për vegla

#### **RM 2 Nxënësi prodhon bishta për çekiçë**

##### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi i materialit.
- Shkurtimi i materialit.
- Drejtimi i materialit..
- Punimi në grosecë i materialit.

- Shkurtimi në përmasa fikse i materialit.
- Dhënia e konicitetit apo formës së caktuar.
- Zumparimi i materialit.
- Lyerja me llak.
- Tharja e llakut.
- Amballazhimi i produkteve të gatshme.
- Magazinimi i produkteve të gatshme.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të bishtave për çekiçë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe shënojë materialin për prodhimin e bishtave për çekiçë;
- të shkurtojë lëndën e parë për bishta, sipas kërkesës;
- të drejtojë me vegla dore bishtat;
- të rrumbullakosë këndet e bishtave;
- të punojë pjesën hyrëse të folesë sipas përmasave;
- të pastrojë sipërfaqen e bishtave siç duhet;
- të lyejë me llak bishtat, sipas kërkesës;
- të zbatojë drejt rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të bishtave për çekiçë;

**RM 3 Nxënësi prodhon doreza për dalta.**

***Përmbajtja***

- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e dorezave për dalta dhe lima.
- Zbërthimi i skicës së dorezave për dalta dhe lima.
- Përgatitja e “tabelës së prerjes”.
- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi i materialit.
- Shkurtimi materialit.
- Drejtimi i materialit.
- Punimi në grosecë i materialit.
- Shkurtimi në përmasa fikse.
- Dhënia e formës së caktuar.
- Hapja e folesë.
- Zumparimi i materialit.
- Lyerja me llak.
- Tharja e llakut.
- Amballazhimi i produkteve të gatshme
- Magazinimi i produkteve të gatshme.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të dorezave për dalta dhe lima.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e dorezave për dalta dhe lima;
- të zbërthejë saktë skicën e dorezave për dalta dhe lima;
- të përgatitë “tabelën e prerjes”, sipas hapave të punës;
- të matë dhe shënojë mbi material, sipas përmasave të caktuara;
- të sharrojë materialin në përputhje me përmasat;
- të shkurtojë materialin në përputhje me përmasat;
- të drejtojë materialin sipas kërkesave;
- të punojë siç duhet në grosecë materialin;
- të shkurtojë në përmasa fikse materialin;
- të japë formën e caktuar materialit;
- të zumparojë materialin sipas kërkesës;
- të lyejë me llak sipas kërkesës;
- të ambalazhojë produktet e gatshme sipas standardit;
- të magazinojë produktet e gatshme në kushte e duhura teknike;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të dorezës së daltës dhe të limës;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant. profesionale të përpunim drurit (zdrukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për përgatitjen e bishtave për çekiç dhe dorezave për vegla.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje, prerje, shkurtime, zumparime dhe lyeje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e bishtave për çekiç dhe dorezave për dalta dhe të lima.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të dorezave të daltave dhe të limave.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e lendes së pare.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për prodhimin e bishtave për çekiç dhe dorezave për dalta e lima.
  - Lëndë e parë drunore, katalogë, manuale, udhëzuesa.
-



## 5. Moduli “Përgatitja e varëseve të rrobave dhe procese të lira”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 10

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E VARËSEVE TË RROBAVE DHE PROCESE TË LIRA	(M-09-1118-15)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar varëse të llojeve të ndryshme për rroba (kremastar) si dhe objekte të ndryshme prej druri	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e varseve të rrobave.**

**Përmbajtja**

- Analiza e skicës së varseve të rrobave dhe skices se lire te objektit
- Përgatitja e “tabelës së prerjes”.
- Përzgjedhja e materialeve për prodhimin varseve të rrobave dhe objektit te lire
- Përzgjedhja e veglave, pajisjet dhe makinave për prodhimin e varseve të rrobave dhe objektit te lire

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë saktë vizatime dhe skica te varseve të rrobave dhe objektit të lirë
- të skicojë elementet përbërës të varseve të rrobave dhe objektit të lirë,
- të përgatisë “tabelën e prerjes”, sipas hapave të punës për prodhimin e varseve të rrobave dhe objektit të lirë.
- të përzgjedhë saktë veglat dhe pajisjet që përdoren në prodhimin e varseve të rrobave dhe objektit të lirë.

**RM 2 Nxënësi përgatit varëse të thjeshta rrobash-kremastar**

**Përmbajtja**

- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi në gjatësi i materialit.
- Shkurtimi i materialit.

- Planimi i detaleve në faqe dhe në brinjë.
- Punimi i detaleve në makinën grosecë,
- Shkurtimi me përmasa fikse i detaleve.
- Prerja me kënd e detaleve.
- Përgatitja e elementeve për lidhje.
- Bashkimi, me lëndë ngjitëse, i detaleve me kompesate.
- Pastrimi i sipërfaqeve pas ngjitjes.
- Rrumbullakimi i buzëve anësore të elementeve të bashkuara
- Zumparimi i varëses së montuar.
- Shpimi për vendosjen e kapses prej teli.
- Vendosja e kapses prej teli.
- Lyerja e varëses me llak.
- Tharja e llakut në varëse.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për prodhimin e varës së thjeshtë kremastar.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë e shënojë, sipas skicës, mbi material për prodhimin e varës kremastar;
- të sharrojë në gjatësi materialin, sipas shënimit;
- të shkurtojë materialin sipas përmasave të caktuara.
- të bëjë planimin e detaleve në faqe dhe në brinjë sipas kërkesave;
- të bëjë punimin e detaleve në makinën grosecë sipas përmasave;
- të shkurtojë në përmasa fikse detalet me sharra rrethore;
- të bëjë prerje me kënd të detaleve me sharrë dore;
- të përgatisë elementet për lidhje prej kompesate me sharrë dore;
- të bashkojë me lëndë ngjitëse, detalet e varëses të rrobave me kompesate;
- të pastrojë saktë sipërfaqen e varëses nga mbeturinat e lëndës ngjitëse;
- të rrumbullakosë buzët anësore të elementeve të bashkuara, të varëses së rrobave me zdrukth dore;
- të zumparojë sipas standardit varësen e rrobave të montuar;
- të bëjë shpimin në vendin e duhur, për vendosjen e kapses prej teli;
- të vendosë saktë kapsen prej teli;
- të lyejë varësen e rrobave me llak sipas standardit të kërkuar;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë saktë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes

së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e varësës së thjeshtë të rrobave kremastar;

### **RM 3 Nxënësi përgatit varëse të thjeshtë muri**

#### ***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi në gjatësi i materialit.
- Shkurtimi i materialit.
- Planimi i detaleve në faqe dhe në brinjë.
- Punimi i detaleve në makinën grosecë
- Shkurtimi i detaleve.
- Rrumbullakimi i buzëve anësore të elementit kryesor që mbështetet në mur.
- Përgatitja e kunjave të rrumbullakta.
- Shpimi për vendosjen e kunjave të rrumbullakta.
- Zumparimi i elementeve të varësës së murit.
- Vendosja e kunjave me lëndë ngjitime.
- Lyerja e varësës me llak ose boj.
- Tharja e llakut ose bojes në varësen e rrobave.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e varësës së murit për rroba.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli..

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë e shënojë mbi materialin drunor sipas kërkesave, për prodhimin e varësës së murit për rroba;
- të sharrojë në gjatësi materialin, sipas shënimit.
- të shkurtojë materialin sipas shënimit;
- të bëjë planimin e detaleve në faqe dhe në brinjë, sipas skicës;
- të punojë detalet në makinën grosecë, sipas përmasave;
- të shkurtojë me përmasa fikse detalet me sharrë dore.
- të rrumbullakosë buzët anësore të elementit kryesor të varësës së murit, sipas skicës;
- të përgatitë kunjat e rrumbullakta, sipas skicës;
- të bëjë shpimet e nevojshme për vendosjen e kunjave të rrumbullakta;
- të vendosë kunjat me lëndë ngjitime.
- të zumparojë elementet e varësës së murit;
- të lyejë varësen me llak ose bojë sipas kërkesës;
- të kontrollojë tharjen e llakut ose bojës në varësen e rrobave sipas tharjes në natyrë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e varësës së thjeshtë të murit për rroba

#### **RM 4 Nxënësi realizon procese pune të lira**

##### ***Permbajtja***

- Regjistrimi i makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Vendosja e lëndës së parë në makinën sharruese.
- Prerja e lëndës së parë.
- Shkurtimi i materialit.
- Drejtimi në makinën plan.
- Punimi në makinën grosecë.
- Punime me përmasa fikse.
- Bashkimi i elementëve.
- Shënimi për prerje
- Sharrimi i detaleve
- Kontrolli i sharrimit.
- Zumparimi i detaleve
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të objektit

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë makinën sharruese sipas përmasave të duhura.
- të presë lëndën e parë sipas skemës së prerjes.
- të shkurtojë materialin sipas skicës.
- të kryejë punimet në makinën plan, në faqe dhe në brinjë.
- të kryejë punimet në makinën grosecë për trashësinë e duhur.
- të kryejë bashkimin e elementeve me vida ose gozhda.
- të shënojë elementet. me anë të skuadrit.
- të sharrojë detale me sharrë dore.
- të kryejë kontrollin e sharrimit.
- të bëjë zumparimin e detaleve
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të objektit

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional të përpunim drurit (zdukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për prodhimin e objektit të lirë dhe të punimeve për prodhimin e varëseve të thjeshta kremastar dhe muri për rroba, me përdorim të veglave dhe pajisjeve të nevojshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve të prodhimit të objektit të lirë për kryerjen e punimeve për prodhimin e varëseve të thjeshta të rrobave, me përdorim të veglave dhe pajisjeve të nevojshme, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.

- 
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e objektit të lirë dhe prodhimin e varseve të rrobave.
  - Rekomandohet që instruktori të pajisë nxënësit me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të punimeve që trajtohen në modul.
  - Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të objektit të lirë dhe varseve të thjeshta të rrobave.
  - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për prodhimin e objektit të lirë
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për prodhimin e objektit të lirë dhe varseve të rrobave.
  - Lëndë e parë drunore.
  - Reparti për punime të marangozit.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për prodhim të varëseve të rrobave dhe objektit të lirë.
  - Materiale ndihmëse për prodhim të varëseve të rrobave dhe objektit të lirë.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa, rregullore, vizatime teknike, skica, etj.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 6. Moduli “Prodhimi i koshit për mbeturina dhe i kutive të thjeshta”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>PRODHIMI I KOSHIT PËR MBETURINA DHE I KUTIVE TË THJESHTA</b>	(M-09-747-11)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar kosha mbeturinash prej kompesate, pllakë fibre dhe me rripa druri, si dhe për të prodhuar kuti të thjeshtë me pllakë fibre dhe dru.	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi prodhon kosh për mbeturina me kompensatë ose me pllakë fibre</b></p> <p><b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e koshit të mbeturinave me kompesatë ose pllakë</li><li>– Matja dhe shënimi mbi kompensatën ose pllakën e fibrës.</li><li>– Sharrimi i kompensatës ose i pllakës së fibrës.</li><li>– Shkurtimi i pllakës.</li><li>– Shkurtimi me përmasa fikse i kompensatës ose pllakës së fibrës.</li><li>– Bashkimi i elementeve.</li><li>– Zumparimi i koshit.</li><li>– Lyerja me bojë ose llak.</li><li>– Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të koshit për mbeturina me kompesatë ose pllakë fibre.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të përgatitë vendin e punës për prodhimin e koshit të mbeturinave me kompesatë ose pllakë fibre;</li><li>– të matë dhe shënojë mbi pllakën e fibrës ose kompensatës sipas skicës për prodhimin e koshit të mbeturinave.</li><li>– të sharrojë kompensatën ose pllakën e fibrës për pjesët anësore dhe për fundin e koshit.</li><li>– të bashkojë elementët me vida, me lëndë ngjitëse apo gozhdë.</li></ul>	

- 
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së koshit të mbeturinave me kompesatë apo pllakë fibre.

## **RM 2 Nxënësi prodhon kosh mbeturinash me rripa druri.**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e koshit të mbeturinave me rripa druri.
- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi imaterialit.
- Shkurtimi i materialit.
- Drejtimi i materialit.
- Punimi në makinën grosecë.
- Shkurtimi me përmasa fikse.
- Bashkimi i elementëve.
- Zumparimi i koshit.
- Lyerja me bojë ose llak.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të koshit për mbeturina me rripa druri.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e koshit të mbeturinave me rripa druri;
- të matë dhe shënojë lëndën e parë sipas skicës për prodhimin e koshit të mbeturinave me rripa druri;
- të shkurtojë materialin drunor për përgatitjen e rripave të drurit;
- të sharrojë materialin drunor për rripat prej druri;
- të drejtojë materialin me makinën plan;
- të punojë në makinën grosec për nxjerjen në trashësi të rripave të drurit;
- të presë rripat e drurit me masa fikse me vegla dore;
- të bashkojë elementët me vida, me lëndë ngjitëse apo gozhdë;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së koshit të mbeturinave me rripa druri;

## **RM 3 Nxënësi prodhon kuti të thjeshtë me pllakë fibre.**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e kutisë së thjeshtë me pllakë fibre.
- Matja dhe shënimi mbi material për prodhimin e kutisë së thjeshtë me pllakë fibre.
- Sharrimi i pllakës së fibrës.
- Kalimi me frezë dore i brinjëve të prodhimeve të sharruara.
- Birimi i elementëve.

- Montimi paraprak i kutisë.
- Mënjanimi i defekteve.
- Montimi përfundimtar i kutisë.
- Prerja e fundit e kutisë.
- Montimi i elementeve të prera me vida filetante.
- Vendosja e fundit të kutisë.
- Kontrolli i cilësisë së punimeve.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për prodhimin e kutive të thjeshta me pllakë fibre.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e kutive të thjeshta me pllakë fibre;
- të matë dhe shënojë mbi material sipas përmasave të kërkuara për prodhimin e kutisë të thjeshtë;
- të sharrojë pllakën e fibrës, sipas përmasave në skicë;
- të montojë paraprakisht kutinë para bashkimit me vida ;
- të mënjanojë defektet në rast se do ketë;
- të montojë kutinë me vida;
- të vendosë fundin e kutisë me piskotina;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së kutisë me pllakë fibre;

**RM 4 Nxënësi prodhon kuti të thjeshtë me dru**

***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit për prodhimin e kutisë së thjeshtë me dru.
- Matja dhe shënimi i lëndës së parë.
- Përgatitja e makinës për prerje të lëndës së parë.
- Vendosja e skuadrit në makinë.
- Përcaktimi i distancave të prerjes (instrument prerës, skuadër).
- Kryerja e sharrimit të lëndës së parë për kutinë.
- Prerja e kompesatës ose e fibrës për fundin e kutisë.
- Bashkimi i elementeve prej druri për skeletin e kutisë.
- Vendosja e fundit të kutisë.
- Kontrolli i cilësisë së punimeve për prodhimin e kutisë.
- Sistemimi i kutive të prodhuara.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kutisë së tueste prej druri.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:



- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e kutive të thjeshta me dru;
- të matë dhe shënojë lëndën e parë, sipas skicës;
- të përgatisë makinën për prerje të lëndës së parë sipas parametrave teknik të saj;
- të vendosë skuadrin në makinë sipas përmasës;
- të sharrojë në makinë elementet përbërës të kutisë sipas përmasave në skicë;
- të përgatisë me saktësi elementet për lidhje;
- të kryejë lidhjen e elementeve të kutisë me lidhje zdrukthare, me ngjitje;
- të pastrojë sipërfaqet e elementeve pas ngjitjes me ngjitës të lëngët;
- të kontrollojë cilësinë e lidhjeve;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të kutisë së thjeshtë me dru;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve për prodhimin e koshave për mbeturina me pjesë anësore kompesat, fibër e me rripa druri, si dhe të kutive të thjeshta me pllakë fibre e dru.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të prodhimit të koshit të mbeturinave dhe kutive të thjeshta, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe pastaj në mënyrë të pavarur në grupe.
- Rekomandohet që instruktori të pajisë nxënësit me materiale të shkruara, skica, udhëzuesa, rregullore, etj., në mbështetje të punimeve që trajtohen në modul.
- Nxënësit duhet të nxiten që të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë aktivisht në lidhje me veprimtaritë praktike që trajtohen në modul.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të koshit të mbeturinave dhe kutisë së thjeshtë me dru dhe pllakë fibre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Reparti për punime të marangozit.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
-

- 
- Materiale të ndryshme drusore për prodhim të koshave për mbeturina me kompensate ose me rripa druri.
  - Materiale ndihmëse për prodhim të koshave për mbeturina.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Lëndë e parë drunore dhe pllakë fibre.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- 



## 7. Moduli “Prodhimi i stolit një e dy vendësh dhe i bangës së shkollës”

**Profili:** Përpunim druri  
**Niveli:** I  
**Klasa:** 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>PRODHIMI I STOLIT NJË E DY VENDËSH DHE I BANGËS SË SHKOLLËS</b>	<b>(M-09-748-11)</b>
<b>Qellimi i modulit</b>	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar stola të thjeshtë një e dy vendësh me kllapa dhe bangë shkolle me pllakë zdrukthi.	
<b>Kohezgjatja e modulit</b>	69 orë mësimore	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	
<b>Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Nxënësi prodhon stol një vendësh me kllapa</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e stolit një vendësh me kllapa.</li><li>– Matja dhe shënimi mbi material.</li><li>– Sharrimi në gjatësi i materialit.</li><li>– Shkurtimi i materialit.</li><li>– Planimi i detaleve në faqe dhe në brinjë.</li><li>– Punimi i detaleve në makinën grosecë.</li><li>– Shkurtimi me përmasa fikse i detaleve.</li><li>– Punimi i kllapave.</li><li>– Prerja me kënd e këmbës dhe traversave ansore.</li><li>– Prerja me kënd e detaleve përforcuese.</li><li>– Montimi i lidhseve.</li><li>– Vendosja e ndenjësës së stolit.</li><li>– Zumparimi i stolit.</li><li>– Stukimi.</li><li>– Lyerja me bojë ose llak.</li><li>– Tharja e llakut ose bojës.</li><li>– Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.</li><li>– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e stolit të thjeshtë një vendësh me kllapa.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>–</li></ul>	

- 
- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e stolit të thjeshtë një vendësh me kllapa;
  - të matë e shënojë mbi materialin drunor për prodhimin e stolit një vendësh, sipas skicës.
  - të sharrojë në gjatësi materialin, sipas shënimit.
  - të shkurtojë materialin sipas shënimit.
  - të bëjë saktë planimin e detaleve në faqe dhe në brinjë, me makinën plan-drejtuese.
  - të punojë detalet në makinën grosecë sipas përmasave.
  - të shkurtojë me përmasa fikse detalet me sharr dore.
  - të bëjë kllapat me sharr dore.
  - të presë me kënd këmbët dhe traversat anësore me sharr dore.
  - të montojë lidhëset e këmbëve të stolit një vendësh.
  - të vendosë ndenjësen e plot ose me rripa të stolit një vendësh.
  - të stukojë vendet e bashkimeve të stolit.
  - të zumparojë stolin e montuar.
  - të lyejë me bojë ose llak stolin sipas kërkesës.
  - të kontrollojë tharjen e bojës në stol.
  - të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e stolit të thjeshtë një vendësh me kllapa.

## **RM 2 Nxënësi prodhon stol dy vendësh me kllapa.**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e stolit dy vendësh me kllapa.
- Matja dhe shënimi mbi material.
- Sharrimi në gjatësi i materialit.
- Shkurtimi i materialit.
- Planimi i detaleve në faqe dhe në brinjë.
- Punimi i detaleve në makinën grosecë.
- Shkurtimi me përmasa fikse i detaleve.
- Punimi i kllapave.
- Prerja me kënd e këmbës dhe traversave anësore.
- Prerja me kënd e detaleve përforcuese.
- Montimi i lidhëseve të vogla.
- Montimi i lidhëseve të gjata.
- Vendosja e ndenjësës së stolit.
- Vendosja e dy përforcuesve.
- Stukimi i stolit.
- Zumparimi i stolit.
- Lyerja me bojë ose llak.
- Tharja e llakut ose bojës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së

mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e stolit të thjeshtë dy vendësh me kllapa.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e stolit të thjeshtë dy vendësh me kllapa;
- të matë e shënojë mbi materialin drunor për prodhimin e stolit dy vendësh, sipas skicës.
- të sharrojë në gjatësi materialin, sipas shënimit.
- të shkurtojë materialin sipas shënimit.
- të bëjë planimin e detaleve në faqe dhe në brinjë, me makinën plan-drejtuese.
- të punojë detalet në makinën grosecë, në faqe dhe në gjerësi, për nxjerrjen e trashësisë së duhur.
- të shkurtojë me përmasa fikse detalet me sharr dore.
- të bëjë kllapat me sharr dore.
- të presë me kënd, këmbët dhe traversat anësore me sharrë dore.
- të presë me kënd përforcuesve të stolit.
- të montojë lidhëset e këmbëve të stolit dy vendësh.
- të vendosë ndenjësen të plot ose me rripa të stolit dy vendësh.
- të vendosë dy përforcues që lidhin këmbët me ndenjësen.
- të zumparojë stolin e montuar.
- të stukojë, lyejë me bojë ose llak stolin.
- të thajë llakun ose bojën në stolin dy vendësh, duke përdorur metodën e tharjes në natyrë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e stolit të thjeshtë dy vendësh me kllapa;

**RM 3 Nxënësi prodhon bang shkollë me pllakë zdrukthi.**

**Përmbajtja**

- Përgatitja e vendit të punës për prodhimin e bangës së shkollës me pllakë zdrukthi..
- Përgatitja e makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Regjistrimi i makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Vendosja e materialit (pllakë zdrukthi) në makinën sharruese.
- Prerja e pllakës së zdrukthit.
- Sistemimi i elementeve të prera.
- Ngjitja e tenisë.
- Prerja e pjesëve të tepërta të tenisë.
- Pastrimi i teheve të tenisë.
- Matja dhe shënimi i elementeve të prera.
- Birimi i elementeve.

- Montimi i elementeve.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të bangës shkollës me pllakë zdrukthi.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë vendin e punës për prodhimin e bangës së shkollës me pllakë zdrukthi;
- të përgatisë makinën për punë sipas parametrave të kërkuara
- të regjistrojë makinën sharruese sipas skicës;
- të përzgjedhë drejt veglat dhe pajisjet për prerje;
- të përzgjedhë pllakën e zdrukthit sipas kërkesave teknike;
- të presë pllakën e zdrukthit për syprinën e bangës dhe të sergjenit për vendosjen e librave, sipas skicës;
- të sistemojë siç duhet elementet e prera;
- të kryejë me kujdes, ngjitjen e tenisë në brinjët e pllakave, me hekur hekurosjeje ose me makinë për ngjitje tenije;
- të matë dhe shënojë pozicionet e hapjes së vrimave sipas skicës;
- të birojë vendet e caktuara sipas skicës;
- të montojë me vida filetante ose bulon dado të pllakës së zdrukthit me skeletin metalik të bangës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të bangës së shkollës me pllakë zdrukthi.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës, reparte ose fabrika të përpunimit të drurit ku prodhohen stola një e dy vendëshe apo banga shkolle.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për prodhimin e stolit të thjeshtë me kllapa një e dy vendësh, si dhe të bangave të shkollës.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për prodhimin e elementeve të stolit e bangës, montimin e tyre si dhe në diskutime në lidhje me probleme të ndryshme që paraqiten gjatë prodhimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi të kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart për punime të marangozit.
  - Komploti i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.

- 
- Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për prodhim të stolave.
  - Materiale ndihmëse për prodhim e stolave.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Komplet i veshjeve të punës.
- 



## 8. Moduli “Prodhimi tabelës së klasës”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I TABELËS SË KLASËS	(M-09-039-11)
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të prodhuar tabelën e klasës me telajo druri dhe fibër.	
Kohëzgjatja e modulit	66 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e bangës së klasës**

***Përmbajtja***

- Analiza e skicës së tabelave të klasës
- Përgatitja e “tabelës së prerjes” së tabelave të klasës.
- Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e tabelave të klasës me telajo druri dhe fibër
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e tabelave të klasës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbërthejë skicën në elementet përbërëse;
- të përgatitë “tabelën e prerjes”, sipas radhës së punës;
- të përzgjedhë materialin për prodhimin e tabelave sipas kërkesës;
- të përzgjedhë saktë veglat dhe pajisjet që përdoren në prodhimin e tabelave të zeza me telajo druri dhe fiber;

**RM 2 Nxënësi pret pllakën e fibrës.**

***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i fibrës
- Përgatitja e makinës për prerje të fibrës.
- Vendosja e skuadrit në makinë.
- Kryerja e sharrimit të fibrës.
- Sistemimi i pllakave të prera të fibrës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prerjes së fibrës.



***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë fibrën sipas kërkesave;
- të përgatisë makinën për prerje të fibrës, sipas parametrave teknik;
- të vendosë skuadrin në makinë, sipas përmasave të caktuara;
- të sharrojë pllakën e fibrës, në makinë sipas kërkesës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prerjes së fibrës;

**RM 3 Nxënësi përgatit tabelën e klasës me telajo druri dhe fibër.**

***Përmbajtja:***

- Matja dhe shënimi mbi material.
- Përgatitja e makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Vendosja e materialit (pllakës së fibrës) në makinën sharruese.
- Sharrimi i pllakës së fibrës.
- Prerja e elementeve të telajos së drurit.
- Sistemimi i elementeve të prera.
- Shënimi i elementeve të prera
- Ngjitja e fibrës në telajon prej druri
- Skuadrimi i tabelës së klasës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të tabelës së zezë me telajo druri dhe fibër.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë saktë elementet prej druri;
- të regjistrojë makinën sharruese për prerjen e materialit sipas përmasave të duhura;
- të vendosë siç duhet, materialin në makinën sharruese;
- të sharrojë në skuadër elementet prej druri, sipas skicës;
- të përgatitë elementet për bashkim, në mënyra të ndryshme;
- të shënojë elementet e prera për bërjen e punimeve të mëtejshme;
- të veshë telajon me pllakë fibre;
- të kontrollojë skuadrimit e tabelës së klasës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të tabelës së klasës me telajo druri;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikantët profesionalë të përpunimit drurit (zdrurthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të prodhimit të tabelës së klasës me dru dhe fibër.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në prodhimin e tabelës së klasës me dru dhe fibër, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e tabelave të klasës me dru dhe fibër.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të tabelave të klasës prej druri dhe fibre.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e drurit dhe të fibrës.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdrurthare.
  - Dru dhe fibër.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 9. Moduli “Prodhimi i komodinës së thjeshtë”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

PERSHKRIMI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I KOMODINES SË THJESHTË	(M-09-040-11)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar një komodinë të thjeshtë pa sirtar, me pllakë zdrukthi.	
Kohezgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e komodinës së thjeshtë me pllakë zdrukthi</b> <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e skicës së komodinës së thjeshtë.</li><li>– Përgatitja e “tabelës së prerjes” së komodinës së thjeshtë.</li><li>– Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e komodinës.</li><li>– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e komodinës së thjeshtë.</li></ul> <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><i>Kriteret e vlerësimit</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbërthejë skicën e komodinës me pllakë zdrukthi në elementet përbërëse;</li><li>– të përgatitë “tabelën e prerjes”, sipas radhës së punës;</li><li>– të përzgjedhë materialet e nevojshme për prodhimin e komodinës;</li><li>– të përzgjedhë saktë veglat, pajisjet dhe makinat për prodhimin e komodinës të thjeshtë me pllakë zdrukthi;</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi prodhon komodinë të thjeshtë me pllakë zdrukthi</b> <i>Përmbajtja</i> Matja dhe shënimi mbi material.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Sharrimi i pllakës të zdrukthit.</li><li>– Shkurtimi i materialit.</li><li>– Prerja me përmasa fikse.</li><li>– Veshja e brinjeve të pllakave me tenin ose rimeso.</li><li>– Birimi i elementeve.</li><li>– Montimi paraprak i komodinës.</li><li>– Mënjanimi i defekteve.</li><li>– Montimi përfundimtar i komodinës.</li></ul>	

- Vendosja e portës.
- Vendosja e dorezës.

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli.

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë e shënojë materialin sipas përmasave të caktuara.
- të sharrojë pllakat e zdrukthit, sipas përmasave në skicë.
- të presë pllakën me përmasa fikse;
- të veshë brinjët e pllakave të prera me temin;
- të birojë elementet për montim;
- të montojë paraprakisht komodinën pa lëndë ngjitëse;
- të mënjanojë defektet në rast se do ketë;
- të montojë në komodinën, me aksesore metalikë dhe plastikë;
- të vendosë menteshat për portën në vendin e caktuar;
- të vendosë portën sipas skicës;
- të vendosë dorezën në portë sipas skicës;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së komodinës;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.
- Instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve për prodhimin e komodinës me pllakë zdrukthi pa sirtar.
- Instruktori mund të organizojë edhe vizita në objekte ndërtimi ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për prodhimin e komodinës të thjeshtë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të prodhimit të komodinës me pllakë zdrukthi pa sirtar në mënyrë të pavarur në grupe.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e tyre.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart për punime të marangozit.
  - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për prodhim të komodinës me pllakë zdrukthi pa sirtar.
  - Materiale ndihmëse për prodhim të komodinës.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesat,
  - Kompleti i veshjeve të punës.
-

## 10. Moduli “Prodhimi i karriges me elementë të drejtë”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIM I KARRIGES ME ELEMENTË TË DREJTË	(M-09-041-11)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar karrige me elemente të drejtë.	
Kohëzgjatja e modulit	67 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e karriges me elementë të drejtë**

***Përmbajtja***

- Analiza e skicës së karriges me elemente të drejtë .
- Përgatitja e “tabelës së prerjes” së karriges me elemente të drejtë.
- Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e karriges me elemente të drejtë.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave që nevojiten për prodhimin e karriges me elemente të drejtë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbërthejë saktë skicën e karriges me elemente të drejtë .
- të përgatitë saktë “tabelën e prerjes”;
- të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e karriges me elemente të drejtë.
- të përzgjedhë drejt veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e karriges me elemente të drejtë;

**RM 2 Nxënësi prodhon ndenjësen e karrigës me elemente të drejtë**

***Përmbajtja***

- Përgatitja e makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Regjistrimi i makinës sharruese për prerjen e materialit sipas përmasave të duhura.
- Vendosja e lëndës së parë në makinën sharruese.
- Prerja e lëndës së parë

- Sistemimi i elementeve të prera.
- Përgatitja e thithave.
- Ndarja e elementeve të ndenjësës
- Matja dhe shënimi i elementeve.
- Matja dhe shënimi i pozicioneve të hapjes së foleve.
- Hapja e foleve.
- Bashkimi i elementeve të drejte me kornizën e ndenjësës.
- Lidhja e elementeve.
- Pastrimi i sipërfaqes së elementeve pas ngjitjes .
- Kontrolli i cilësisë së lidhjeve.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të ndenjësës së karriges me elemente të drejtë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë makinën sharruese për prerjen e materialit, sipas parametrave të caktuara.
- të regjistrojë makinën sharruese për prerjen e materialit sipas përmasave të duhura.
- të vendosë, siç duhet, lëndën e parë në makinën sharruese.
- të sharrojë lëndën e parë në përputhje me përmasat e caktuara.
- të sistemojë elementet e prera sipas asortimentit.
- të përgatitë thithat sipas skicës;
- të matë dhe shënojë mbi elementet e prera vendet e lidhjeve, sipas skicës.
- të bëjë thithat dhe e foleve për bashkim.
- të bashkojë elementet e drejtë me kornizën e ndenjësës, sipas skicës.
- të kryejë lidhjen e elementeve me ngjitës të lëngët, me vida.
- të pastrojë sipërfaqen e elementeve pas ngjitjes me ngjitës të lëngët.
- të kontrollojë cilësinë e lidhjeve.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të ndenjësës së karriges me elemente të drejtë.

**RM 3 Nxënësi përgatit këmbët e karriges dhe lidhëset e tyre**

***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i lëndës së parë.
- Përgatitja e makinës për prerje të lëndës së parë.
- Vendosja e skuadrit në makinë.
- Përcaktimi i distancave të prerjes (instrument prerës, skuadër).
- Sharrimit i lëndës së parë për këmbët e karriges dhe

lidhseve të tyre.

- Përgatitja për lidhje e këmbëve dhe e lidhseve të tyre.
- Zumparimi i këmbëve të karriges dhe lidhseve të tyre.
- Lyerja me llak ose bojë e këmbëve të karriges.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të këmbëve të karriges dhe lidhseve të tyre.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë lëndën e parë sipas skicës.
- të përgatisë makinën për prerje të lëndës së parë sipas parametrave teknik.
- të vendosë skuadrin në makinë sipas përmasave.
- të sharrojë këmbët e karriges dhe lidhëset e tyre sipas skicës.
- të përgatitë sipas skicës këmbët dhe lidhëset për lidhje.
- të lyejë me bojë ose llak elementet përbërës të karriges sipas kërkesës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të këmbëve të karriges dhe lidhseve të tyre.

**RM 4 Nxënësi prodhon karrige me elemente të drejta.**

***Përmbajtja***

- Kontrolli i pjesëve përbërëse të karriges.
- Montimi paraprak i elementeve të karriges.
- Mënjanimi i defekteve.
- Montimi përfundimtar i karriges.
- Kontrolli i cilësisë së karrigës së prodhuar.
- Sistemimi i karrigeve të prodhuara
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të karriges.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë cilësinë e punimeve të elementeve përbërës të karriges
- të kryejë montimin paraprak të karrigës sipas modelit.
- të më njanojë defektet e mundshme të dalë në pah nga montimi paraprak.
- të montojë përfundimisht karriken sipas radhës së punës.
- të kontrollojë cilësinë e karrigës së montuar.
- të sistemojë karriget e prodhuara sipas kushteve teknike.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të karriges.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant profesional të përpunimit drurit (zdukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të prodhimit të karrigeve me elementë të drejtë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje dhe prerje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e karriges me elemente të drejtë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të karriges me elemente të drejtë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e lëndës së parë.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdukthare.
  - Lëndë e parë
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Prodhimi i ndenjësive të thjeshta me tapiceri

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I NDENJESEVE TË THJESHTA ME TAPICERI	(M-09-042-08)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të prodhuar ndenjësive të thjeshtë të tapicuara (pufe)	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e pufesë</b> <b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e skicës së pufe-së (ndenjësive me tapiceri).</li><li>– Përgatitja e “tabelës së prerjes” së pufesë.</li><li>– Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e pufe-së.</li><li>– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e pufe-së.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbërthejë skicën sipas rradhës në elementët përbërës;</li><li>– të përgatitë me kujdes “tabelën e prerjes” së pufesë.</li><li>– të përzgjedhë saktë materialet për prodhimin e pufesë;</li><li>– të përzgjedhë sipas kërkesës veglat , pajisjet dhe makinat për prodhimin e pufesë;</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi prodhon skeletin e ndenjësive së pufesë</b> <b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Matja dhe shënimi mbi material për prodhimin e ndenjësive.</li><li>- Sharrimi i pllakës së fibrës ose kompensatës.</li><li>- Shkurtimi i materialit.</li><li>- Drejtimi i materialit.</li><li>- Punimi në makinën grosecë.</li></ul>	

- Prerja me masa fikse.
- Përgatitja e kllapave
- Përgatitja e kembeve.
- Zumparimi i këmbëve
- Lyerja e këmbëve
- Montimi i elementeve për formimin e ndenjësës
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes e mjedisit gjatë prodhimit të skeletit të ndenjësës me tapiceri.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë sipas skicës mbi material për prodhimin e ndenjësës.
- të sharrojë sipas shënimit mbi pllakën e fibrës ose kompensatës për ndenjësën.
- të sharrojë sipas përmasave në skicë.
- të shkurtojë materialin sipas përmasës;
- të drejtojë materialin sipas trashësisë të kërkuar.
- të punojë në makinën grosecë sipas trashësisë të kërkuar.
- të presë sipas skicës me masa fikse detalet;
- të përgatisë kllapat sipas skicës;
- të përgatisë këmbët sipas skicës;
- të zumparojë këmbët sipas shkallës të pastërtisë
- të lyejë këmbët sipas kërkesës me bojë ose llak;
- të montojë elementet për formimin e ndenjësës
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes të mjedisit gjatë prodhimit të skeletit të ndenjësës me tapiceri;

**RM 3 Nxënësi përgatit tapicerinë e ndenjësës**

***Përmbajtja***

- Prerja e sfungjerit.
- Preja e mbulesës.
- Lyerja sfungjerit me lëndë ngjitëse.
- Vendosja e sfungjerit në skeletin e ndenjësës.
- Vendosja e mbulesës.
- Mbërthimi i mbulesës.
- Montimi i këmbëve.
- Kontrolli i cilësisë
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tapicerisë së ndenjësës;

***Instrumentet e vlerësimit***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të presë sfungjerin sipas përmasës në skicë;
- të presë mbulesën sipas përmasës në skicë;
- të lyejë sfungjerin, sipas normativës, me lëndë ngjitëse;
- të vendosë sfungjerin, me kujdes, në skeletin e ndenjësës;

- të vendosë mbulesën, sipas kërkesës, me igelit, damaskë etj;
- të mbërthejë mbulesën sipas preventivit me thumba tapicerie etj;
- të montojë këmbët sipas skicës;
- të kontrollojë cilësinë sipas standartit;
- të zbatojë me rigorozitet rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së tapicerisë së ndenjësës;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në bazën prodhuese të shkollës ose të organizohen vizita mësimore në punishte, reparte, ndërmarrje ku prodhohen objekte druri të tapicuara.
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për prodhimin e ndenjësëve të thjeshta me tapiceri (pufesë), fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e pufesë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për prodhimin e ndenjësës të thjeshtë me tapiceri.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi të kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Per realizimin si duhet te modulit eshte e domosdoshme te sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e meposhtme:
- Repart për punime të marangozit.
  - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për prodhim të koshave për mbeturina me kompensate ose me rripa druri.
  - Materiale ndihmëse për prodhim të koshave për mbeturina.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhezuesa,
  - Kompleti i veshjeve te punës.
- 



## 2. Moduli “Prodhimi i krevatit për të rritur”

Drejtimi: Përpunim druri

Niveli: I

Klasa: 10

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	PRODHIMI I KREVATIT PËR TË RRITUR	(M-09-043-08)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të prodhuar krevate për të rritur, “tek” dhe “dopio” me pllakë zdrukthi ose fibre.	
Kohëzgjatja e modulit	36 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar arsimin e detyruar	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM1</b>	<b>Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e krevatit për të rritur.</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e vizatimit teknik ose e skicës së krevatit.</li><li>– Paraqitja në vizatim ose skicimi i elementeve përbërëse të krevateve për të rritur.</li><li>– Përgatitja e “tabelës së prerjes”.</li><li>– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave që nevojiten për prodhimin e krevateve.</li><li>– Përzgjedhja e materialeve që përdoren për prodhimin e krevateve për të rritur</li></ul> <b>Intrumetet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të analizojë saktë vizatimin teknik apo skicën e krevatit;</li><li>– të paraqesë saktë në vizatim elementet përbërëse të krevateve për të rritur;</li><li>– të përgatitë saktë “tabelën e prerjes” për prodhimin e krevatit për të rritur; të përzgjedhë saktë veglat, pajisjet dhe makinat që nevojiten për prodhimin e krevateve.</li><li>– të përzgjedhë materialet që përdoren për prodhimin e krevateve për të rritur, sipas kërkesave;</li></ul>
	<b>RM 2</b>	<b>Nxënësi prodhon krevat “tek” me pllakë zdrukthi dhe fibre</b> <b>Përmbajtja</b> <ul style="list-style-type: none"><li>– Matja dhe shënimi i pllakës të zdrukthit, fibrës.</li></ul>

- Sharrimi i balleve të krevatit.
- Dhënia e formës sipas shabllonit.
- Sharrimi i pjesëve anësore.
- Veshja e brinjëve me tenin.
- Vendosja e aksesorëve metalik.
- Paketimi i krevatit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së krevatit “tek” për të ritur, me pllak zdrukthi ose fibre.

***Intrumetet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mate dhe shënojë pllakën e zdrukthit, fibrës sipas skicës;
- të sharrojë pllakën për të nxjerr ballet e krevatit;
- të japë formën e duhur balleve të krevatit sipas shabllonit;
- të sharrojë pllakën për të nxjerrë pjesët ansore të krevatit;
- të veshë brinjët e balleve dhe të fjankeve me teninë;
- të vendosë aksesorët metalikë për bashkimin e balleve me pjesët anësore;
- të bëjë paketimin e krevatit “tek” me pllakë zdrukthi, fibre;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së krevatit “tek”, për të ritur, me pllak zdrukthi, fibre;

**RM 3 Nxënësi prodhon krevat “dopio” me pllak zdrukthi, fibre**  
***Përmbajtja***

- Matja dhe shënimi i pllakës të zdrukthit, fibrës.
- Sharrimi i balleve të krevatit.
- Dhënia e formës sipas shabllonit.
- Sharrimi i pjesëve anësore.
- Veshja e brinjëve me teninë.
- Vendosja e aksesorëve metalikë.
- Paketimi i krevatit.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së krevatit “dopio” për të ritur, me pllakë zdrukthi, fibre.

***Intrumetet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mate dhe shënojë pllakën e zdrukthit, fibrës sipas skicës.
- të sharrojë pllakën për të nxjerrë ballët e krevatit.
- të japë formën e duhur balleve të krevatit sipas shabllonit.
- të sharrojë pllakën për të nxjerr pjesët ansore të krevatit.
- të veshë brinjët e balleve dhe të fjankeve me teninë.
- të vendosë aksesorët metalik për bashkimin e balleve me pjesët anësore.

- të bëjë paketimin e krevatit “dopio” me pllakë zdrukthi, fibre.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë përgatitjes së krevatit “dopio” për të rritur, me pllakë zdrukthi, fibre

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe të organizohen vizita mësimore në objekte ku kryhen punime si: prodhime të krevateve për të rritur, “tek” dhe “dopio”
- Mësuesi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të përdorimeve të drejta të veglave dhe pajisjeve gjatë përgatitjes së elementeve për prodhimin e krevatit për të rritur.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për prodhimin e krevateve për të rritur me pllakë zdrukthi, fibre Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Repart për punime të marangozit.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumenta prerëse.
  - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për prodhim të koshave për mbeturina me kompensate ose me rripa druri.
  - Materiale ndihmëse për prodhim të koshave për mbeturina.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
  - Komplet i veshjeve të punës.
- 



### 3. Moduli “Shtrimi i dyshemesë me dërrasë”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	SHTRIMI I DYSHEMESË ME DËRRASË	(M-09-044-08)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të shtruar trarët mbështetës si dhe për shtrimin e dyshemesë me dërrasë.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për shtrimin e dyshemesë me dërrasë.**

***Përmbajtja***

- Matja e sipërfaqes për shtrim të dyshemesë.
- Llogaritja e bazës materiale të nevojshme për shtrim.
- Përshtatja e vendit të punës për shtrimin e dyshemesë me dërrasë.
- Përzgjedhja e veglave dhe mjeteve të nevojshme për punë.
- Grumbullimi i trarëve mbështetës.
- Grumbullimi i dërrasave për shtrim të dyshemesë
- Transportimi i trarëve dhe dërrasave në vendin e duhur
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe dërrasave.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë saktë matjen e sipërfaqes për shtrim të dyshemesë;
- të llogaritë me saktësi bazën materiale të nevojshme për shtrim;
- të përshtatë vendin e punës për shtrimin e dyshemesë me dërrasë;
- të përzgjedhë saktë veglat dhe mjetet e nevojshme për punë;
- të grumbullojë trarët mbështetës sipas përmasave dhe numrit të caktuar;
- të grumbullojë dërrasat e përgatitura për shtrim të dyshemesë.
- të transportojë me shumë kujdes trarët dhe dërrasat në

---

vendin e duhur;

- të zbatojë me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe dërrasave;

## **RM 2 Nxënësi shtron trarët mbështetës**

### ***Përmbajtja***

- Kontrollimi i nivelit të traut të parë.
- Nivelimi i traut të fundit.
- Nivelimi i trarëve të ndërmjetëm njëri me tjetrin.
- Fiksimi i trarëve anësor të niveluar.
- Fiksimi i trarëve të ndërmjetëm.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe dërrasave.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e realizimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë nivelin e traut të parë, sipas standardit;
- të nivelojë traun e fundit, duke iu referuar traut të parë;
- të nivelojë trarët ndërmjetës duke iu referuar trarëve kufizues;
- të bëjë fiksimin e saktë të trarëve anësor të niveluar;
- të bëjë saktë fiksimin e trarëve të ndërmjetëm;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë grumbullimit dhe transportimit të trarëve dhe dërrasave .

## **RM 3 Nxënësi shtron dyshemenë me dërrasë.**

### ***Përmbajtja***

- Shtrimi i dërrasës së parë.
- Fiksimi i dërrasës së parë.
- Shtrimi i dërrasave në vazhdim.
- Fiksimi i dërrasave.
- Vendosja e kornizave anësore.
- Zumparimi i dërrasave të shtruara.
- Lyerja e dyshemesë prej dërrase.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë shtrimit të dyshemesë me dërrasë.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të shtrojë saktë dërrasën e parë të dyshemesë;
- të fiksojë siç duhet dërrasën e parë të dyshemesë;
- të shtrojë me saktësi dërrasat në vazhdim;
- të fiksojë dërrasat duke i shtrënguar me morseta;



- të vendosë saktë kornizat anësore;
- të kryejë zumparimin e dyshemesë me dërrasë;
- të kryejë lyerjen e dyshemesë me ngjyrues, me dyll bletësh, me llak, me poliuretan parketi etj sipas kërkesës;
- të kujdeset për veglat e pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë shtrimit të dyshemesë me dërrasë;

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit (zdrukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të prerjes së lëndës së parë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje dhe prerje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për shtrimin e dyshemeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e shtrimit të dyshemeve.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me postë pune për matjen dhe prejen e lëndës së parë.
  - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdrukthare.
  - Lëndë e parë.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

#### 4. Moduli “Prodhimi i dyerve tamburato”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIMI I DYERVE TAMBURATO	(M-09-045-08)
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson nxënësit për të prodhuar dyer tamburato, me paturë në sharrë.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	

**Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit**

**RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e dyerve tamburato**

***Përmbajtja***

- Analiza e skicës së dyerve tamburato.
- Paraqitja në vizatim e derës tamburato.
- Përgatitja e “tabelës së prerjes”.
- Përzgjedhja e materialit për prodhimin e dyerve tamburato.
- Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave që nevojiten për prodhimin e dyerve tamburato.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të analizojë saktë vizatimet dhe skicat e dyerve tamburato;
- të skicojë elementet përbërës të dyerve tamburato;
- të përgatitë saktë “tabelën e prerjes” së dyerve tamburato;
- të përzgjedhë materialet që përdoren për prodhimin e dyerve tamburato me paturë në sharrë;
- të përzgjedhë saktë veglat dhe pajisjet që përdoren në prodhimin e dyerve tamburato me paturë në sharrë.

**RM 2 Nxënësi përgatit në sharrë elementet e telajos prej druri**  
***Përmbajtja***

- Regjistrimi i makinës sharruese për prerjen e materialit.
- Vendosja e lëndës drunore në makinën sharruese.
- Prerja e lëndës drunore
- Prerja e pllakës së fibrës.
- Sistemimi i elementeve të prera.
- Ndarja e elementeve.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.

- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të telajos prej druri në makinën sharrë.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë makinën për punë sipas përmasave të elementeve të telajos;
- të presë lëndën e parë sipas skemës së prerjes;
- të presë pllakën e fibrës sipas skemës së prerjes;
- të sistemojë elementet sipas vendosjes në telajo;
- të ndajë elementet e kornizës dhe të mbushjes;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prodhimit të telajos prej druri.

**RM 3 Nxënësi kryen drejtimin e elementeve**

***Përmbajtja***

- Përgatitja e makinës për drejtimin e lëndës së parë.
- Vendosja e skuadrit në makinë.
- Drejtimi i elementeve të kornizës.
- Drejtimi i elementeve mbushës të kornizës.
- Matja dhe kontrolli i elementeve të drejtuar.
- Kujdesi për veglat dhe instrumentat prerës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë drejtimit të elementeve.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë makinën plandrejtuese dhe grosecë për drejtimin e lëndës së parë;
- të vendosë saktë skuadrin në makinë;
- të drejtojë elementet e derës sipas skicës;
- të kontrollojë matjen e elementeve të drejtuar;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë prerjes së elementeve;

**RM 4 Nxënësi përgatit elementet për lidhjen ndërmjet tyre**

***Përmbajtja***

- Përzgjedhja e veglave dhe pajisjeve për lidhje dhe bashkim.
- Matja dhe shënimi i elementeve.
- Përgatitja e makinave për punë.
- Vendosja e skuadrit në makinë.
- Përcaktimi i distancave të prerjes: instrument prerës, skuadër.
- Hapja e kanaleve.

- Formimi i thithave.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë përgatitjes së elementeve për lidhje dhe bashkimin e tyre.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë saktë veglat dhe pajisjet për lidhjen dhe bashkimin e elementeve;
- të masë dhe shënojë elementet, sipas skicës;
- të përgatisë makinën për prerje të elementeve sipas skicës;
- të vendosë skuadrin në makinë, sipas përmasave;
- të hapë kanalën në traversën gjatësore të telajos;
- të përgatitë faqet e thithave sipas përmasave;
- të kontrollojë cilësinë e lidhjeve;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë përgatitjes së lëndës së parë;

**RM 5 Nxënësi prodhon derën tamburat**

***Përmbajtja***

- Lyerja e thithave me lëndë ngjitëse.
- Futja e thithave në kanalën e traversave gjatësore.
- Vendosja e përforcueses në pozicionin e bravës.
- Lyerja e sipërfaqeve të kontaktit material drunor-fibër.
- Vendosja e pllakave prej fibre, në pozicion për ngjitje.
- Pastrimi i sipërfaqes nga lënda ngjitëse.
- Presimi i derës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë ngjitjes së elementeve dhe të fibrës.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë drejt pajisjet për lyerje me lëndë ngjitëse;
- të përgatisë lëndën ngjitëse për ngjitje;
- të lyej me lëndë ngjitëse sipas normave të konsumit të lëndës ngjitëse për metër katror;
- të kryej lidhjen e traversave me thitha;
- të pastrojë sipërfaqet e elementeve pas ngjitjes me ngjitës të lëngët;
- të kryejë presimin e derës tamburato;
- të kontrollojë cilësinë e lidhjeve;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë ngjitjes së elementeve dhe të fibrës;

## RM 6 Nxënësi realizon paturën e derës

### *Përmbajtja*

- Skuadrimi i derës në makinën sharrë.
- Drejtimi i brinjëve me zdrukth dore të mekanizuar.
- Vendosja e skuadrës në makinë për krijimin e paturës.
- Fiksimi i distancës: mjet prerës-skuadër.
- Kryerja e paturës në sharrë.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë përgatitjes së paturës në sharrë.

### *Instrumentet e vlerësimit:*

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### *Kriteret e vlerësimit:*

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të përzgjedhë drejt veglat pajisjet dhe makinat për bërjen e paturës.
- të bëjë skuadrimin e derës në makinën sharrë, sipas përmasave fikse.
- të drejtojë saktë brinjët me zdrukth dore të mekanizuar.
- të vendosë skuadrin në makinë, për krijimin e paturës.
- të fiksojë distancat: mjet prerës – skuadër sipas kërkesës.
- të kryejë paturën e derës në sharrë, sipas modelit.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtja e mjedisit gjatë bërjes së paturës.

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikatat profesionale të përpunimit drurit (zdrukthari).
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të punës për prodhimin e dyerve tamburato.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për prodhimin e dyerve tamburato, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e dyerve tamburat me paturë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prodhimit të dyerve tamburat me paturë.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

### **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prejen e lëndës së parë.
-

- 
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për punime zdrukthare.
  - Lëndë e parë dhe fibër.
  - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- 



## 5. Moduli “Ndërtimi i nyjes së kapriatës së thjeshtë me lëndë druri”

Drejtimi: Përpunim druri  
Niveli: I  
Klasa: 11

### PERSHKUESII I MODULIT

Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I NYJES SË KAPRIATËS SË THJESHTË ME LËNDË DRURI	(M-09-1119-15)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të ndërtuar nyje të kapriatës së thjeshtë me lëndë druri.	
Kohezgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësi duhet të ketë përfunduar modulet e praktikës profesionale të kl.10 të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I.	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës për prodhimin e nyjes së kapriatës me lëndë druri</b> <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Analiza e skicës së nyjes së kapriatës së thjeshtë me elementet përbërëse.</li><li>– Përgatitja e “tabelës së prerjes” së nyjes së kapriatës.</li><li>– Përzgjedhja e materialeve për prodhimin e nyjes së kapriatës.</li><li>– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për prodhimin e nyjes së kapriatës.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit</b> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– të zbërthejë skicën e nyjes së kapriatës së thjeshtë prej druri me elementet përbërëse, sipas radhës së montimit.</li><li>– të përgatitë saktë “tabelën e prerjes” së nyjes së kapriatës së thjeshtë prej druri.</li><li>– të përzgjedhë saktë materialet e nevojshme për prodhimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë prej druri.</li><li>– të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për prodhimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë prej druri.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi ndërton nyje të kapriatës së thjeshtë prej druri</b> <i>Përmbajtja</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Matja dhe shënimi mbi material për prodhimin e nyjes së kapriatës.</li><li>– Sharrimi i materialit.</li><li>– Shkurtimi i materialit.</li></ul>	

- Prerja në sharrë e materialit
- Përgatitja e lidhjeve zdrukthëtare.
- Hapja e vrimave te elementet.
- Montimi paraprak i nyjes së kapriatës.
- Mënjanimi i defekteve.
- Montimi përfundimtar i nyjes së kapriatës.
- Kontrolli i cilësisë së nyjes së kapriatës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve ndërtimin e nyjes së kapriatës
- **Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli..

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe shënojë mbi material për prodhimin e nyjes së kapriatës.
- të sharrojë materialin për prodhimin e elementeve të nyjes së kapriatës.
- të shkurtojë materialin për prodhimin e elementeve të nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- të përgatitë lidhjet zdrukthëtare në elementet përbërëse të nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- të hapë vrimat elementet përbërëse të nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- të montojë paraprakisht nyjen e kapriatës së thjeshtë.
- të mënjanojë defektet që vihen re gjatë montimit për nyjen e kapriatës së thjeshtë.
- të bëjë montimin përfundimtar të nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- të kontrollojë cilësinë e nyjes së kapriatës së thjeshtë;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për ndërtimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të përpunimit të drurit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e punimeve për ndërtimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- Mësuesi i praktikës mund të organizojë edhe vizita në objekte ndërtimi ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për ndërtimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punime konkrete të prodhimit të nyjes së kapriatës së thjeshtë, mënyrë të pavarur dhe në grupe.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet me tepër theksi te kontrolli i demonstrimit praktik të veprimeve nga ana e nxënësve.



---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për punime të marangozit.
  - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të marangozit.
  - Instrumente prerëse.
  - Instrumente shënuese, matëse dhe kontrolluese.
  - Materiale të ndryshme drusore për ndërtimin e nyjes së kapriatës së thjeshtë dhe materiale ndihmëse.
  - Fletë konstruktive të kapriatës së thjeshtë me lëndë druri.
  - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzues,
  - Kompleti i veshjeve të punës.
- 

